Kronikë

Plagosi inxhinerin e ERE-së se kishte lidhje me gruan e tij, zbardhet dëshmia e policit të vetëdorëzuar: Nuk kisha qëllim ta vrisja! Ku dyshojnë hetuesit

Autori u vetëdorëzua në policinë e Tiranës pasditen e djeshme i pashoqëruar nga askush madje as nga avokati i tij. Burime pranë grupi hetimor thonë se Goxhara ka dhënë detaje mbi motivin dhe rrethanat, disa prej të cilave janë parë me dyshim për vërtetësinë e tyre nga hetuesit.

■ U njohën në moshën 13 vjeç dhe i kërkoi dorën kur ishte 15...! Historia e dashurisë së efektivit dhe bashkëshortes së tij që e tradhtoi me shefin e ERE

■ Tiranë/ Atentat për tradhti Lorenc Kostës, vetëdorëzohet pas 48 orësh Erjon Goxhara! Efektivi: Isha i rënduar psikologjikisht! Gruaja pranoi lidhjen me inxhinierin e ERE

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Keti Banushi
22 Gusht, 10:08 | **Përditësimi: 22 Gusht, 16:11**

Share

Zbardhen detaje nga vetedorezimi i efektivit Erjon Goxhara i cili akuzohet se plagosi inxhinierin e ERE Lorenc Kosta. Autori u vetëdorëzua në DVP Tiranë pasditen e të mërkurës i pashoqëruar nga askush madje as nga avokati i tij. Burime pranë grupi hetimor thonë se Goxhara ka dhënë detaje mbi motivin dhe rrethanat, disa prej të cilave janë parë me dyshim për vërtetësinë e tyre nga hetuesit.

> *"Kam qenë në lokal duke drekuar me vajzën time, kam parë Lorenc Kostën rastësisht. Kam çuar diku vajzën dhe jam kthyer ku edhe kam qëlluar ndaj tij. Nuk e kam bërë me paramendim, dhe nuk kam patur për qëllim ta vras. Kam përdorur armën e shërbimit që mbaja me vete".*

Policia ka negociuar me të afërmit për të bindur autorin për tu dorëzuar.

LEXO EDHE:
Sherri mes të 'fortëve' në Tiranë pas aksidentit të vajzave, arrestohet i plagosuri Fatjon Dauti, kishte armë e kanabis! 3 në kërkim

Pavarësisht Goxhara mbajti këtë qëndrim, grupi i hetimit nuk është bindur për vertetësinë e deklarimeve. Rrethanat, provat materiale dhe dëshmitë e personave të tjerë, krijojnë bindjen e arsyeshme se efektivi i policisë e ka ndjekur shënjestrën dhe e ka planifikuar ngjarjen.

Veç kësaj, Goxhara kishte krijuar të gjitha kushtet ditën e ngjarjes për të realizuar qëllimin. Ende nuk është arritur të merret dëshmia e viktimës së sulmit Lorenc Kosta për shkak të gjendjes shëndetësore. Ndërkohë pritet të dalë para gjykates. Deri tani policia e ka referuar në prokurori për akuzen e vrasjes me paramendim të mbetur në tentative.

Ngjarja e rëndë ndodhi mesditën e 19 gushtit në një zonë të populluar të Tiranës ndërsa efektivi u vetëdorëzua pasditen e 21 gushtit. Ndaj Erjon Goxharës rëndon akuza e vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë.

Çfarë thuhet në dosje

Në dosje thuhet se efektivi kishte zhvilluar një takim me bashkëshorten dhe nipin e tij, L.B në një qendër Tregtare.

Gjatë këtij takimi, në dosje thuhet se gruaja ka pranuar tradhtinë, por nuk ka pranuar që t'i kërkojë ndjesë efektivit Goxhara. Sipas saj, tradhtia ka ndodhur vetëm një herë. Të njëjtën ditë, Goxhara pasi përfundon këtë bisedë, zhvendoset pranë lagjes ku jetonte, dhe ka plagosur Lorenc Kostën, i cili po ashtu jetonte në atë zonë.

Pasi e la të mbuluar me gjak, e filmoi atë çfarë bëri dhe videon ia dërgon të ***plagosurit në telefon***. "**Mëso të mos futesh më në shtëpitë e të tjerëve, dhe të hash djersën e tyre**". I plagosuri, aktualisht është jashtë rrezikut për jetën

Në deklarimet e dhëna para Oficerëve të Policisë Gjyqësore në prezencë të psikologut, djali efektivit ka konfirmuar konfliktet mes prindërve të tij që nga mesi i korrikut, kohë kur sipas tij, e ***ëma pranon dyshimet*** e Goxharës për lidhjen jashtë martesore me Kostën.

S.G/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Erjon Goxhara | lorenc kosta | Tirane

Komento

Komente

Se di: 23/08/2024 01:03

.. por askujt nuk i ben persht hypje qe autori ka nr e telefonit te viktimes??

Përgjigju

Ileshi: 22/08/2024 17:40

DUHEJ TA VRISJE_QE TE ZENE MEND TE TJERET_QE GRUAJA E TJETRIT NUK PREKET...

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ngjarjet e fundit në vend ju shqetësojnë për nivelin e sigurisë?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Tiranë/ 'Fërkuan' makinat luksozë, plas sherri mes 2 shoferevë! Thërrasin në ndihmë 'të fortët', njëriti i vihen prangat në spitalI! U gjenden armë e hashash

22 Gusht, 22:45

PRECEDENTËT/ Eskortat e huaja po kërkojnë 'parajsën' në Shqipëri, 5 raste vetëm për 2024! Nga Azia, Europa dhe Amerika, për të rrezikuar edhe jetën

22 Gusht, 18:28

Nga 1 Janari, pensionistët do udhëtojnë falas në urban! Veliaj: Tabela dixhitale dhe në çdo stacion autobusi, çmimi i biletës nuk do rritet

22 Gusht, 14:02

Dështon sërish protesta e opozitës para bashkisë së Tiranës! Pamjet me dron! Shikoni sa pak janë! Këllinçi sulmon ndërkombëtarët: Jeni të kapur

22 Gusht, 12:10

U njohën në moshën 13 vjeç dhe i kërkoi dorën kur ishte 15...! Historia e dashurisë së efektivit dhe bashkëshortes së tij që e tradhtoi me shefin e ERE

22 Gusht, 10:53

Goditet rrjeti i prostitucionit në Tiranë, pranga tutores kineze! Vajzat nga Kina e Filipine i 'reklamonin' në 'Escort Tirana', i dhunonin dhe u zhvasnin deri në 15 mijë € që t'i linin të lira

22 Gusht, 10:26

Tiranë/ Atentat për tradhti Lorenc Kostës, vetëdorëzohet pas 48 orësh Erjon Goxhara! Efektivi: Isha i rënduar psikologjikisht! Gruaja pranoi lidhjen me inxhinierin e ERE

21 Gusht, 17:37

Tragjedia e mësuesit amerikan, asnjë familjar nuk ka tërhequr trupat nga morgu

Keti Banushi

21 Gusht, 15:52

E PLOTË! Dinamika e plagosjes në Tiranë/ Polici insistoi të dëgjonte 'MË FAL'! Gruaja i pranoi vetëm një flirt

Anila Priftì

Keti Banushi

21 Gusht, 14:05

Para se të plagoste inxhinierin e ERE në Tiranë, efektivi takoi gruan e nipin! Debate e tensione, bashkëshortja pranoi tradhtinë: Ndodhi vetëm një herë

Keti Banushi

21 Gusht, 10:02

Kush ishte gruaja që u vra nga amerikani në Tiranë, në shtëpinë e saj mund të shkoje vetëm kur ai nuk ishte aty

21 Gusht, 09:29

I dënuar me 15 vite burg për trafik të miturish, 58-vjeçari ekstradohet nga Greqia! Bleu fëmijën për 10 mijë lekë dhe e shfrytëzoi për të lypur

21 Gusht, 08:26

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje